



INSTITUTI I KURRIKULËS DHE TRAJNIMIT

PROGRAMET E KURRIKULËS BËRTHAMË TË GJIMNAZIT

FUSHA: ARTE

LËNDA: ART PAMOR

KODI: 1.1

PROGRAMET E LËNDËS ART PAMOR PËR KLASAT 10-12

TIRANË, SHTATOR 2008

Arti pamor është një nga lëndët artistike që përmban fusha e arteve në gjimnaz, dhe ashtu si të gjitha lëndët e tjera brenda fushës së arteve, luan një rol të rëndësishëm në edukimin e nxënësve të kësaj grupmoshe, duke u nxitur imagjinatën, zhvilluar ndjenjën e së bukurës dhe duke u mësuar atyre rrugët për të kuptuar botën dhe mjedisin që i rrethon.

Arti pamor komunikon nëpërmjet gjuhës së simboleve, përmes të cilave nxënësit mësojnë të identifikojnë vlera estetike dhe njerëzore në vepra të ndryshme arti dhe të kuptojnë ndikimin e artit në shoqërinë njerëzore. Përmes kësaj lënde ata do të komunikojnë dhe do të zhvillojnë aftësitë e tyre artistike, jo vetëm përmes gjykitimit estetik, arsyetimit, mendimit kritik, por edhe përmes krijimit konkret në punë 2 -3 dimensionale.

Krijimet e ndryshme që do të realizohen përmes punës në klasë, do t'i motivojnë ata të përfshihen në mënyrë aktive në jetën artistike të shkollës, komunitetit dhe në rang vendi.

Kjo lëndë kërkon që përmes studimit të përmbajtjes, që ajo ofron, të arrihen qëllimet kryesore të lëndës, duke dhënë kontributin e saj në *zhvillimin personal* të nxënësve, si dhe duke u dhënë mundësinë atyre të shohin vetveten si pjesë e shoqërisë dhe kontribues aktivë në të. Lënda ndihmon dhe në *përgatitjen e nxënësve si qytetarë aktivë të një shoqërie evropiane*.

1. SYNIMI I LËNDËS

Ky program synon:

Të ndihmojë në formimin estetik dhe kulturor të nxënësve, duke i orientuar drejt kuptimit të mjeteve shprehëse, duke i njohur me elementet dhe parimet mbi të cilat mbështetet krijimtaria e arteve pamore, duke interpretuar e vlerësuar kulturën dhe veprat e artit kombëtar e botëror përmes vëzhgimit, analizës, interpretimit dhe vlerësimit të këtyre veprave.

2. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Në përfundim të këtij programi nxënës/i, - ja:

- të përdorë elementet dhe parimet e artit në vepra të ndryshme të artit klasik dhe bashkëkohor;
- të zgjedhë materiale, teknika dhe mjete të ndryshme dhe t'i përdorë ato me kompetencë në krijimet e veta;
- të komunikojë përmes një terminologjie artistike rreth zhvillimit të historisë së artit në periudha dhe kontekste të ndryshme kulturore, duke interpretuar vlerat artistike;
- të zhvillojë aftësitë e të menduarit kritik dhe krijues në procese të ndryshme të krijimit dhe realizimit në artin pamor;

- të identifikojë veprat e artit nëpërmjet periudhave, përmbajtjeve, temave, stileve, metodave, teknikave dhe materialeve;
- të shpjegojë disa lloj stilesh të ndryshme, duke i dalluar ato përmes kontekstit social, historik dhe kronologjik;
- të identifikojë aftësitë e tij në lloje të ndryshme të artit pamor dhe ta shohë atë si një mundësi për profesionin e tij të ardhshëm.

3. OBJEKTIVA SIPAS LINJAVE

54 javë x 1 orë = 54 orë

Linja 1: Estetika e arteve dhe arti pamor¹

Përshkrimi i linjës: Kjo linjë ka për qëllim të njohë nxënësit me ligje të përgjithshme të estetikës që karakterizojnë artin në përgjithësi dhe krijimtarinë artistike në veçanti. Nxënësit njihen me objektin e artit, kategoritë estetike, klasifikimin e arteve në muzikë, art pamor, kërcim dhe teatër, si dhe lidhjen e tyre me njëri-tjetrin. Këto ligje të përgjithshme të artit dhe veçoritë e tij në raport me veprimtari të tjera të njeriut dhe shoqërisë, shërbejnë si urë për të kaluar në njohjen e secilit lloj arti në veçanti.

Orët e sugjeruara²: 5

Linja	Objektiva
Estetika e arteve dhe arti pamor	<p>Në përfundim të këtij programi nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të shpjegojë artet si pjesë e objektit të <i>estetikës</i>; • të dallojë konkretisht <i>cilësitë estetike</i> në një vepër arti (muzikë, teatër, art pamor dhe kërcim); • të klasifikojë artet: muzikë, art pamor, kërcim dhe teatër, sipas <i>mjeteve të tyre shprehëse</i>; • të përshkruajë dallimin ndërmjet <i>artëve të thjeshta</i> dhe

1. Estetika do të zhvillohet nga përdoruesit e programit (mësuesit dhe autorët e teksteve si një linjë e përbashkët, *nëse do të jetë një tekst për të katër lëndët*, pasi edhe çështjet e vendosura si kërkesë për studim janë të njëjta, duke veçuar vetëm klasifikimin e arteve sipas mjeteve të tyre shprehëse). Orët e estetikës, pikërisht në objektivat me përmbajtje të përbashkët, realizohen në mënyrë të përbashkët për të dyja lëndët. Edhe objektivat që lidhen specifikisht me lëndën e zgjedhur do të shpjegohen dhe realizohen në mënyrë të përbashkët për të dyja lëndët. Orët e mbledhura për të dyja lëndët e përzgjedhura janë 10 orë, nga të cilat 4 orë mund të përdoren për shpjegimin e kuptimit të përgjithshëm të estetikës për të gjitha artet dhe 6 orët e mbetura mund të planifikohen sipas specifikave estetike të lëndës së përzgjedhur (3+3).

² Orët e sugjeruara janë orët e planifikuara nga specialistët për zhvillimin e linjës. Shuma totale e orëve të linjave duhet të jetë sa numri i plotë i orëve në planin mësimor për këtë lëndë. Quhen të sugjeruara sepse i jepet liri zbatuesit të programit (mësuesit) që të shtojë, ose të pakësojë numrin e sugjeruar të orëve në masën 10 % sipas nevojave të klasës.

	<p>arteve të përbëra;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajë lidhjet e llojeve të ndryshme të arteve me njëri – tjetrin; • të shpjegojë ndryshimin ndërmjet tri teorive të artit (<i>imitacionalizmi, formalizmi, emocionalizmi</i>); • të përshkruajë ndryshimin e shijeve estetike pamore, duke u nisur nga krahasimi i dy veprave të periudhave të ndryshme; • të argumentojë parapëlqimet e veta artistike në grup, familje etj., (si p.sh. pse i pëlqen një vepër arti e periudhës së Rilindjes nga një vepër arti e shek. të 20-të); • të shkruajë një ese ose një artikull kritik mbi vlerat estetike të një veprë arti, të një periudhe të caktuar; • të shpjegojë rrugët përmes të cilave duhet të orientohet për të parë një galeri arti p.sh: <i>llojin e artit që ekspozohet, ku dhe kur ekspozohen punimet, rregullat para, gjatë dhe pas vizitës në një galeri arti etj.</i>
--	---

Linja 2: Elementet dhe parimet e artit pamor

Përshkrimi i linjës: Në këtë linjë nxënësit kuptojnë *elementet* dhe *parimet* e artit pamor, që ndryshe quhen edhe gjuha e artit, të cilat janë (**elementet:** *ngjyra, vija, sipërfaqja, forma 2 dimensionale, forma 3 dimensionale, hapësira* dhe **parimet:** *balanca, theksi, variacioni, harmonia, lëvizja, ritmi, proporcionet*) bazë për krijimin e një veprë arti. Nxënësit njihen me mënyrën e organizimit të elementëve në vepra të ndryshme arti, në mënyrë të tillë që ata vetë të kuptojnë se si mund të merret mesazhi nga një vepër arti. Gjithashtu, ata aftësohen në përdorimin dhe organizimin e këtyre elementeve në punimet e tyre, përmes të cilave komunikojnë ide dhe qëndrime.

Orët e sugjeruara: 6

Linja	Objektiva
Elementet dhe parimet e artit pamor	<p>Në përfundim të këtij programi nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të vlerësojë rolin që kanë <i>ngjyra, vlera, linja, sipërfaqja, forma 2 dimensionale, forma 3 dimensionale</i> dhe <i>hapësira</i> në procesin e krijimit artistik të një veprë artistike pamore; • të identifikojë mënyrat e ndryshme të përdorimit të elementeve në një vepër konkrete arti (balanca, theksi, harmonia, variacioni, kontrasti, lëvizja, ritmi dhe proporcionet); • të analizojë artistikisht një vepër arti duke u nisur nga <i>elementet e artit pamor</i>; • të analizojë se si arrihet <i>uniteti i veprës së artit</i>

	<p>nëpërmjet përdorimit me sukses të elementeve dhe parimeve të artit pamor;</p> <ul style="list-style-type: none"> të përdorë terminologjinë e duhur dhe një fjalor specifik në analizën e një vepre arti (elementet dhe parimet janë fjalori vizual i përdorur nga artistët).
--	--

Linja 3: Procese të realizimit dhe krijimit artistik

Përshkrimi i linjës: Nxënësit në këtë linjë krijojnë punë 2 dhe 3 dimensionale, duke njohur dhe përdorur proceset e ndryshme të krijimit dhe realizimit të një vepre arti. Njohuritë që nxënësit do të marrin për mjetet dhe proceset e realizimit, do t'i aftësojnë ata për t'i dhënë formë ideve dhe ndjenjave në punët e tyre. Gjithashtu, në këtë linjë nxënësit njihen me historikun e krijimit, të zhvillimit të mediave dhe proceseve të krijimit artistik në artin pamor.

Orët e sugjeruara: 17

Linja	Objektiva
Procese të realizimit dhe krijimit artistik	<p>Në përfundim të këtij programi nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> të krijojë punë 2 dimensionale, duke përzgjedhur për realizimin e saj një nga mjetet e mëposhtme: <ul style="list-style-type: none"> a. vizatimi (mjete të thata dhe të njoma); b. piktura (mjetet dhe materialet e pikturës); c. printimi (metodat dhe mjetet e litografisë, serigrafisë etj.); d. fotografia (kamera fotografike, letra fotografike etj.). të krijojë punë 3 dimensionale, duke përzgjedhur për realizimin e saj një nga mjetet e mëposhtme: <ul style="list-style-type: none"> a) llojet e skulpturës (relieve, skulpturë e rumbullakët, materialet dhe mjetet e skulpturës); b) proceset e skulpturës; c) modeli (argjila, allçia); d) gdhendja (në gur, dru, mermer); e) derdhja (në metal ose substanca të lëngëta); f) assemblazhi (ngjitja e materialeve të ndryshme). të përdorë mjetet, teknikat dhe proceset në mënyrë të sigurt gjatë krijimit të një pune artistike, si: në krijimin e një grafike, krijimin e një pikturë, krijimin e një skulpturë me plastelinë apo baltë etj.; të përdorë në mënyrë të vazhdueshme një fjalor specifik për fushën e arteve në përshkrimin e materialeve, proceseve apo punëve të ndryshme artistike të krijuara.

Linja 4: Historia e artit pamor, bota dhe shoqëria

Përshkrimi i linjës: Në këtë linjë, përveç njohjes me zhvillimin e artit pamor në periudha të ndryshme historike, nxënësit njihen me karakteristikat historike, shoqërore dhe kulturore të krijimit të veprave të artit në këto periudha. Përmes kësaj linje nxënësit analizojnë dhe krahasojnë vepra të ndryshme arti, duke përdorur një gjuhë të thjeshtë artistike, duke shpjeguar karakteristikat e periudhave, stileve dhe autorëve të ndryshëm. Për herë të parë do të vijë edhe njohja konkrete, përmes vlerave reale të artit figurativ shqiptar dhe përfaqësuesve të saj në periudha të ndryshme.

Orët e sugjeruara: 22

Linja	Objektiva
Historia e artit pamor, bota dhe shoqëria	<p>Në përfundim të këtij programi nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none">• të zbatojë hapat që ndjekin <i>historianët dhe kritikët e artit</i> në vlerësimin e një veprë arti (përshkrimi, analiza, interpretimi, gjykimi);• të analizojë fillimet e artit pamor në shoqërinë njerëzore e deri në ditët tona, duke përdorur kërkimet, krahasimet, diskutimet dhe debatin rreth <i>karakteristikave historike, stilistike dhe estetike</i> të periudhave historike të artit dhe arkitekturës shqiptare dhe botërore:<ul style="list-style-type: none">- Arti antik: prehistorik, arti në Mesopotami, arti Grek, arti Romak, Kristianizmi i hershëm, Arti bizantin, Arti egjiptian, Arti Egje etj.- Arti shqiptar dhe ndikimi nga kultura të tjera: kultura ilire, Arti Grek i kolonive (Butrinti, Apolonia, Dyrrahu), Mozaikët e lashtë në Shqipëri.- Arti në mesjetë: Arti islamik, Mesjeta e hershme, Romanik, Gotik, Arti afrikan, Arti kinez, qytetërimet e hershme në Amerikë.- Arti në Rilindje: Gotiku i vonë, Rilindja e parë, Rilindja e lartë, Manjerizmi, Baroku, Rokoko, Onufri, arti në Shqipëri – ikonografët e shek. XVIII.- Arti modern: Neoklasiçizmi, Romantiçizmi, Realizmi, Impresionizmi, Postimpresionizmi, arti në Shqipëri - periudha e Pavarësisë, arti në vitet njëzet të shek. XX, arti bashkëkohor, realizmi socialist në Shqipëri.

	<ul style="list-style-type: none"> • të krijojë një qëndrim personal gjatë analizës që i bën zhvillimit historik dhe njohjes së veprave të artit (për të realizuar një ese, një projekt etj.), duke u mbështetur në disa kritere: <ul style="list-style-type: none"> - periudhën dhe autorin, - ndikimet, - mjedisin social e shoqëror ku u krijua vepra, - organizimi i elementeve dhe parimeve të veprës, - mesazhi që përcjell, - teknikat dhe materialet e përdorura. • të vlerësojë <i>mjetet dhe teknikat</i> që përdoren në artin pamor, duke përshkruar <i>zhvillimin dhe përsosjen</i> e tyre përgjatë periudhave p.sh: (përshkruan mënyrën e krijimit të pikturave të shpellave dhe materialet e përdorura); • të vlerësojë kontributin dhe ndikimin që kanë patur kulturat tek njëra – tjetra në krijimtarinë e artistëve të ndryshëm p.sh: arti kinez, afrikan etj., (ndikimi i Pikasos nga arti afrikan etj.); • të klasifikojë veprat e artit sipas <i>specifikave ose stileve historike</i>; • të interpretojë se si disa nga punimet e veta janë influencuar nga stile dhe vepra arti të ndryshme (krijime që mbështeten në periudha dhe në artistë të ndryshëm); • të debatojë mbi një vepër arti, duke e nisur analizën nga përdorimi i elementeve dhe parimeve të artit; • të ideojë vetë ose në grup, një projekt që ka të bëjë me zhvillimin historik të një arti të caktuar, si p.sh.: evoluimi i pikturës nga shek. XV deri në ditët tona, vepra dhe përfaqësues; • të diskutojë mbi ndikimin e artit te vetja dhe në shoqëri, pa paragjykuar mendimet e të tjerëve, p.sh.: ndikimin e artit bashkëkohor etj.; • të marrë pjesë si pjesëmarrës ose organizator në veprimtari të ndryshme artistike në klasë, shkollë, mjedisin ku jeton, në komunitet dhe shoqëri; • të përshkruajë lloje të ndryshme të karrierës në artin pamor, duke u mbështetur në llojin dhe nivelin e arsimimit e talentin, kushtet e punës, mundësitë e punësimit, pagën etj.
--	---

Linja 5: Teknologjia dhe media

Përshkrimi i linjës: Në këtë linjë nxënësit kuptojnë rëndësinë dhe rolin që luan zhvillimi i teknologjisë dhe mediave në procesin e krijimit dhe realizimit artistik në artin pamor, si dhe në krijimin e formave të reja shprehëse artistike. Në këtë linjë, një vend të veçantë do të zërë rëndësia e teknologjisë në zhvillimin e artit bashkëkohor dhe në zhvillimin e arteve funksionale, si dhe mundësinë për t'i parë ato në zhvillimin e vetvetes për të bërë karrierë.

Orët e sugjeruara: 4

Linja	Objektiva
Teknologjia dhe media	<p>Në përfundim të studimit të këtij programi nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none">të përshkruajë zhvillimin e teknologjisë dhe përdorimin e saj në artet pamore, gjë e cila ka sjellë zhvillimin e formave të reja të artit si: <i>arti i kompjuterit, fotomontazhi, video, video montazhi etj.</i>;të përshkruajë efektet që krijojnë ndriçimi në skenë, vendosja e duhur e ndriçuesve sipas këndit të dritë – hijes etj;të vlerësojë si mundësi karriere (ose ndihmëse në karrierën e tij) dhe përshkruajë një nga profesionet e ndryshme të artit pamor si: <i>dizajni grafik, dizajni dhe moda, arkitektura, dizajni i ambienteve të brendshme, dizajni industrial, artist i lirë, mësues i lëndëve të artit, arkeologji, kurator etj.</i>

4. KËRKESA TË ARTIT PAMOR NDAJ LËNDËVE TË TJERA

ART PAMOR	TEKNOLOGJIA
Struktura e lëndëve Teknologjia e ndërtimit Teknologjia e shtypit. Stampimi	Nxënës/i, -ja: <ul style="list-style-type: none">të njohë strukturën lëndore, vetitë dhe sipërfaqet;të njohë teknologjinë e ndërtimeve të ndryshme arkitektonike dhe inxhinierike;të njohë teknologjinë e shtypit.
ART PAMOR	HISTORI
Të gjitha periudhat e zhvillimit të historisë njerëzore janë të lidhura me artin pamor.	Nxënës/i, -ja: <ul style="list-style-type: none">të përshkruajë ngjarjet historike, sociale, politike dhe kulturore që kanë lënë gjurmë në secilën periudhë historike;të përshkruajë kthesat e mëdha historike që kanë

	ndikuar fort në zhvillimin e shoqërisë njerëzore të këtyre periudhave.
--	--

5. KËRKESA PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Ky program është dokument zyrtar, një pjesë e tërësisë së dokumenteve zyrtare për lëndën e artit pamor. Dokumentet e tjera kryesore janë korniza kurrikulare e gjimnazit dhe standardet e fushës kurrikulare të arteve, ku kjo lëndë bën pjesë. Hartimi i programit është mbështetur si te korniza kurrikulare, ashtu edhe te standardet e fushës.

Për të siguruar përdorimin sa më të mirë të programit është e vlefshme njohja me dokumentet e lartpërmendura.

Te korniza kurrikulare vëmendje e veçantë i duhet kushtuar:

- Synimeve të përgjithshme të kurrikulës së gjimnazit,
- Synimeve të linjave ndërkurrikulare,
- Vlerësimit të nxënësit me notë,
- Parimeve të mësimdhënie-mësimnxënies.

Në mënyrë që tërësia e dokumenteve zyrtare (korniza kurrikulare, standardet e fushës së të nxënësve dhe programi lëndor) të zbatohen më së miri në dobi të nxënësve, përdoruesit e tyre duhet të njohin thellë programet lëndore të lëndës së artit pamor për klasën paraardhëse dhe në vijim.

Gjithashtu, përdoruesve të këtyre dokumenteve u lind nevoja të njohin standardet e fushës dhe të të gjitha fushave të tjera të të nxënësve për të gjitha programet lëndore të të njëjtit vit.

Fusha e arteve vjen për herë të parë në **gjimnaz** në mënyrë të plotë përsa i përket kohës, përmbajtjes dhe strukturës, duke zhvilluar përmbajtjet e katër lëndëve, të cilat janë: muzika, arti pamor, teatri dhe kërcimi. Studimi i dy prej këtyre lëndëve mund të jenë kombinimet: *a) muzikë – kërcim b) art pamor – teatër*, apo edhe kombinime të tjera. Fusha e arteve për herë të parë ka një pamje të plotë, duke zhvilluar katër lëndë brenda saj me një përmbajtje të mjaftueshme kulturore për qëllimin që ka shkolla e mesme publike.

Arti pamor në **gjimnaz** studiohet në 54 orë mësimore, përkatësisht në 3 semestra me nga 1 orë në javë. Raporti i vëllimit midis njohurive dhe veprimtarive, në lëndën e artit pamor është 60 me 40, pasi kjo lëndë synon në zhvillimin e aftësive në krijimin e punimeve të ndryshme artistike 2 dhe 3 dimensionale, apo realizimit të tyre përmes përdorimit të mediave dhe mjeteve të ndryshme.

Kurrikula e artit pamor e konceptuar për gjimnazin do të thellojë dhe zgjerojë përvojat e fituara nga nxënësit në arsimin e detyruar, duke zhvilluar më tej aftësitë krijuese, duke rritur ndjeshmërinë ndaj të bukurës si dhe duke shprehur emocionet në krijimet e tyre individuale. Programi i artit pamor organizohet sipas linjave të përmbajtjes dhe për çdo linjë shënohen objektivat të cilat materializojnë elemente, njohuri mbi artin, aftësi dhe qëndrime që pritet të fitojnë nxënësit gjatë studimit të këtij programi.

Ky program nuk kërkon që nxënësit të memorizojnë dhe riprodhojnë në mënyrë mekanike periudhat historike, veprat dhe përfaqësuesit e çdo periudhe, por të krahasojnë, të ngrenë hipoteza, të përshkruajnë dhe të mbajnë qëndrim kritik, duke vlerësuar

opinionet e gjithsecilit. Linja e estetikës ndihmon nxënësit për të vlerësuar të bukurën në art, për të argumentuar një vepër arti dhe pse, kjo vepër për të është e bukur apo jo, duke përdorur një gjuhë të zgjedhur dhe të qartë artistikisht. Kjo lëndë ka edhe aspektin krijues, ku nxënësit krijojnë punime të ndryshme artistike, jo më në mënyrë spontane, por në mënyrë profesionale.

Për zhvillimin e kësaj lënde mësues/i,-ja punon vetëm dhe në grup, zhvillon biseda, konkurse, veprimtari artistike etj.

Zbatimi i programit duhet të bëhet duke respektuar parimet e barazisë gjinore, etnike, kulturore, racore dhe fetare.

Zhvillimi i të menduarit kritik për vlerësimin e një vepre arti

Për të formuar në mënyrë të drejtë artistike aftësitë e nxënësve në artin pamor, duhet që mësues/i,-ja të drejtojë nxënësit, duke i njohur me hapat nëpër të cilat duhet të kalojë analiza e një vepre arti: përshkrimi, analiza, interpretimi dhe gjykimi. Kjo gjë i bën nxënësit më të aftë jo vetëm për të njohur vepra të ndryshme arti, por edhe për të reaguuar dhe mbajtur qëndrim në mënyrë artistike ndaj tyre. Zhvillimi i qëndrimit kritik dhe aftësisë për të interpretuar në mënyrë artistike një vepër arti, është një nga detyrat e mësuesit. Në përdorimin e përditshëm, termi “kritik” ka ngjyresën e një qëndrimi mosmiratues, kurse këtu ka të bëjë me analizën, sintezën dhe vlerësimin si procese mendore tipike. Të menduarit kritik del i domosdoshëm në rastet e zgjidhjes së një shtate problemore ose të marrjes së një vendimi. Pjesë e rëndësishme e të menduarit kritik është kujdesi i posaçëm dhe i përhershëm ndaj paragjykimeve vetjake ose të të tjerëve, anësisë, keqinformimit etj. Mësuesit duhet t’i japin mundësinë secilit nxënës që të kultivojë të menduarin kritik ndaj informacioneve, ngjarjeve, dukurive dhe qëndrimeve.

Programi i artit pamor kërkon nga zbatuesit që kjo lëndë të mos zhvillohet si një lëndë teorike, por si një lëndë praktike që zhvillon aftësitë për të krijuar punë të ndryshme arti si dhe ***për të vëzhguar, analizuar, interpretuar e vlerësuar ato.***

Për zhvillimin e kësaj lënde, një rol të rëndësishëm ka *mjedisi* ku do të punohet dhe mjetet didaktike mësimore (telajo, penela, bojëra etj.), që mundësojnë zbatimin e linjave të programit. Linja e elementeve dhe parimeve si dhe linja e procesit dhe realizimit, mundësojnë punën krijuese të nxënësve, ku secili duhet të punojë në mënyrë individuale. Për realizimin e projekteve kërkohet bashkëpunimi dhe puna në grup. Kjo gjë varet nga tematika që do të përzgjidhet. Një rëndësi të madhe ka edhe përdorimi i pajisjeve si: kompjuter për njohjen dhe përdorimin e programeve të ndryshme të artit, televizor, video apo DVD për njohjen e veprave të autorëve të ndryshme.

Objektivat e programit

Objektivat e programit janë për të gjithë nxënësit. Kjo do të thotë se që të gjithë nxënësve duhet t’u jepet mundësia për të nxënë çka përshkruhet tek objektivat. Realizimi i objektivave në tema, kapituj, njësi, si dhe renditja e tyre është zgjedhje e lirë e zbatuesit të programit.

Orët e estetikës, pikërisht në objektivat me përmbajtje të përbashkët, realizohen në mënyrë të përbashkët për të dyja lëndët. Ndërsa objektivat që lidhen specifikisht me lëndën e zgjedhur do të shpjegohen dhe realizohen nga secila lëndë më vete. Orët e mbledhura për të dyja lëndët e përzgjedhura janë 10 orë, nga të cilat 4 orë janë për

kuptimin e përgjithshëm të estetikës në të gjitha artet dhe 6 orët e mbetura do të ndahen sipas specifikave estetike të lëndës së përzgjedhur (3+3).

P.sh.: Objektivi: “Të shpjegojë artet si pjesë e objektit të *estetikës*” kërkon që të gjithë nxënësit duhet të njohin estetikën si një shkencë që studion artet dhe përkufizojnë objektin e saj.

Një objektivi përmbushet në nivele të ndryshme nga nxënës të ndryshëm. Mësuesi dhe autorët e materialeve mësimore duhet të mbulojnë të gjithë gamën e niveleve të nxënësve.

P.sh.: Objektivi: Të shpjegojë *tri teoritë e artit* dhe të arsyetojë se si këto teori ndryshojnë nga njëra-tjetra (*imitacionalizmi, formalizmi, emocionalizmi*) kërkon që të gjithë nxënësve duhet t’u jepet mundësia që të shpjegojnë *tri teoritë e artit* në mënyrë të sigurt, por jo nga të gjithë do të pretendohet i njëjti nivel i shpjegimit të këtyre tri teorive.

Një tjetër nivel arritjeje është shpjegimi i *tri teorive të artit* në situata të ngjashme me shembujt e sapo mësuar. Një nivel më i lartë se ky është përdorimi i këtyre njohurive në situata të reja për nxënësin, por brenda njohurive të linjës së dhënë. Një nivel edhe më i lartë do të ishte përdorimi dhe zbatimi në njohuritë e linjave të tjera të artit pamor, pastaj të lëndëve të tjera e më në fund në një situatë të stimuluar dhe nga vetë bota reale.

Orët mësimore

Programi i artit pamor është strukturuar në linja që vijnë njëra pas tjetrës, por nuk do të thotë se mësimdhënia-mësimnxënia duhet të zhvillohet në këtë renditje gjatë vitit shkollor.

Sasia e orëve mësimore për secilën linjë është rekomanduese. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, por janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara për secilën linjë.

Domethënë, mësues/i,-ja mund të vendosë të vazhdojë më ngadalë kur vë re se nxënësit hasin vështirësi të veçanta në përmbushjen e objektivave të linjave, por mund të ecë më shpejt kur nxënësit demonstrojnë një përvetësim të kënaqshëm.

Në programin e lëndës së artit pamor afërsisht **60%** e totalit të orëve mësimore janë për shtjellimin e njohurive dhe aftësive të reja lëndore, ndërsa **40%** e tyre janë për përpunimin e tyre (gjatë vitit dhe në fund të vitit shkollor).

Përpunimi i njohurive

Përpunimi i njohurive përmban:

- Përsëritjen brenda një linje të njohurive-bazë të tij (konceptet themelore);
- Testimin e njohurive-bazë;
- Integrimin e njohurive të reja të një linje me njohuritë e linjave paraardhëse;
- Integrimin e njohurive të reja me njohuritë e lëndëve të tjera brenda fushës së arteve dhe më tej (me fizikën, kiminë, gjuhën shqipe, gjuhën e huaj etj.). (Ndonëse këto integritime do të përshkojnë zhvillimin e çdo ore mësimore, gjatë përpunimit i duhet kushtuar kohë e posaçme);
- Përsëritjen vjetore (pavarësisht nga ndarja në linja, lënda duhet parë si një e tërë);
- Testimin vjetor (nuk është i detyruar).

Në orët mësimore, që i përkasin përpunimit të njohurive dhe aftësive, mësuesi zhvillon edhe tema me nismën e tij ose me kërkesën e vetë nxënësve. Këto tema mund të pikënisjen nga ngjarje aktuale ose thjesht nga kureshtja e nxënësve.

Veçanërisht gjatë përpunimit të njohurive duhet t'i kushtohet kohë e posaçme kultivimit të:

- Aftësive të posaçme lëndore:

krijuese- shkrimin e një eseje, duke krahasuar karakteristikat midis dy veprave të artit dhe sjellë një opinion dhe qëndrim personal;

krijuese- krijimin e një punë të vetën 2-3 dimensionale (pikturë, grafikë, skulpturë etj.), duke përcjellë emocionet dhe ndjeshmërinë e vet individuale;

komunikuese - komunikimin e saktë të njohurive, mendimeve dhe qëndrimeve rreth artit pamor, përmes një terminologjie artistike;

analizuese - analizimin e një vepre arti përmes elementeve dhe parimeve të artit pamor, të cilat përbëjnë një vepër, dhe që ndihmojnë për të patur një fjalor të saktë artistik gjatë analizës së një vepre;

krahasuese - krahasimin dhe renditjen e karakteristikave të dy veprave arti, të realizuara nga autorë të ndryshëm, por që i përkasin të njëjtës periudhë historike.

- **Formimit të qëndrimeve**, si qëndrimi etiko-social etj., dhe gjatë punës në grupe të vogla nxënësish.

Gjatë orëve të përpunimit të njohurive, nxënësve duhet t'u krijohet mundësia të punojnë detyra tematike bazuar mbi një tematikë të caktuar (peizazh, portret etj.), projekte kurrikulare etj.

Një nga kërkesat për zbatimin me sukses të këtij programi është edhe zhvillimi i punës me nxënësit që mund të kenë vështirësi me aftësitë motorike për të punuar një detyrë të dhënë (pikturë, grafikë etj.), për të punuar një program të caktuar në kompjuter etj. Kështu mësuesit të lëndës i del si detyrë, lehtësimi i nxënësve nga këto procese, duke i kërkuar realizimin e detyrave që nuk përbëjnë problem fizik dhe emocional të tyre.

Por në këtë grup mund të hyjnë edhe nxënësit me vështirësi në të nxënë, me të cilët mund të punohet veçmas, duke i ndihmuar ata të realizojnë detyrat dhe të arrijnë rezultate të kënaqshme.

Për realizimin e këtij programi sigurisht ka nevojë që mësues/i,-ja të përdorë edhe metodat që nxitin nxënësit e talentuar. Kjo do të thotë se klasa apo grupi që ka zgjedhur këtë lëndë, gjithmonë mund të ketë individë të cilët "shkëlqejnë" apo janë talente të lindur në realizime të punëve të ndryshme artistike, përdorimin e programeve kompjuterike etj. Pra, është detyrë e mësuesit që të evidentojë dhe të zhvillojë këto talente.

6. VLERËSIMI

Vlerësimi i nxënësit përshkon gjithë procesin mësimor dhe shërben për përmirësimin e këtij procesi. Vlerësimi i nxënësit nuk ka për qëllim të vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në objektivat, programin lëndor dhe mësuesi/ja nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ato objektiva të arritjes që nuk përshkruhen në program.

Objektiv i vlerësimit nuk janë vetëm njohuritë dhe aftësitë, por edhe qëndrimet e nxënësve, si qëndrimet etiko-sociale në përgjithësi dhe ato të bashkëpunimit me të tjerët në veçanti.

Mësues/i,-ja zhvillon vetë, dhe në bashkëpunim me nxënësit, një larmi mënyrash vlerësimi, që kanë të bëjnë me:

1. bërjen e artit përmes krijimeve të ndryshme 2 -3 dimensionale;
2. përdorimin e saktë të *materialeve, teknikave dhe mjeteve* të ndryshme me kompetencë në krijimet e tyre;
3. përcaktimin e individit (nxënësit) më të suksesshëm gjatë debatit për krahasimin e 2 veprave të artit, duke folur për periudhën e krijimit, përmbajtjen, tematikën, stilit që i përkasin, metodave, teknikave dhe materialeve;
4. krahasimin e eseve në trajtimin e çështjeve të artit pamor ku sillen opinione apo mendime, argumentohet dhe krijohet një qëndrim personal ndaj çështjes së ngritur.

Nxënës/i, - ja vlerësohet me notë, ndërsa demonstroi arritjet në punë të ndryshme, si: krijimi i punëve 2 -3 dimensionale, shkrimi i një ese-je etj., vëzhgimi një veprë arti dhe mbajtja qëndrim, marrja pjesë në veprimtari të ndryshme artistike që organizon shkolla etj.

Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup, në klasë ose jashtë saj.

Nxënës/i, - ja vlerësohet me notë, ndërsa demonstroi arritjet në punë konkrete si psh: *realizimi i punëve 2 dhe 3 dimensionale, interesimi për ndjekjen e jetës artistike në komunitet, pasioni, vlerësimi dhe përkushtimi* ndaj kësaj lënde etj.

Në punime të nxënësve me grupe të vogla, mësuesi/ja parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit në tërësi dhe të secilit nxënës në veçanti.

Mësues/i,-ja nuk e ka të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënësve në çdo orë mësimore dhe të vendosë nota në regjistër për secilën orë mësimore. Si rregull, nxënësit dhe mësues/i,-ja duhet të bashkëbisedojnë lirshëm si partnerë rreth përvetësimit të njohurive të fituara të orëve të kaluara dhe mirë kryerjes së detyrave jashtë klase.

Herë pas here mësues/i,-ja duhet të vlerësojë me notë, duke ua bërë të qartë nxënësve që në fillim qëllimin e vlerësimit dhe kriteret e tij.

Portofoli i nxënësit, si një mundësi vlerësimi e vetvlerësimi, është një koleksion i punimeve të tij përgjatë vitit shkollor. Ai mund të përmbajë detyra tematike (ese), krijime të ndryshme 2 dhe 3 dimensionale të realizuara gjatë vitit shkollor që mund të jenë krijime në pikturë, skulpturë (plastelinë), kompjuter etj., projekte kurrikulare, të gjitha në dobi të veprimtarive të ndryshme shkollore, produkte të veprimtarive kurrikulare etj. Përzgjedhjet për portofolin bëhen nga nxënësit, mësues/i,-ja rekomandon.